



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragash Municipality
Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport



Datë: 19/01/2024

Dragash

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 400/04-2119/24
19.01.2024
Dragash - Dragaš

Në bazë të nenit 58, ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-40, dhe nenit 12 të Rregullores mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve 04/2017, Kryetari i Komunës *nxjerr këtë:*

V E N D I M

Për shpalljen e Thirrjes publike për mbështetje financiare për projekte të organizatave joqeveritare në fushën e Kulturës.

I

Për implementimin e Thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit/nënprogramit 85009/0820.

II

Mjetet e përmendura në nenin I do të shpërndahen në bazë Thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

III

Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij Vendimi përfshin:

1. Teksti i Thirrjes publike;
2. Udhëzimet për aplikantët;
3. Formularët e aplikimit;
4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve; dhe
5. Format për raportimin e zbatimit të projektit.

Formularët e aplikimit, referuar paragrafit të këtij neni janë:

1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit;
2. Forma e buxhetit të programit apo projektit;
3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta;
4. Forma e deklarimit të konfliktit të interesit;
5. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme);
6. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike; dhe
7. Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit, e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatim.

Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit;
2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin;
3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit;

IV

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (<https://kk.rks-gov.net/dragash/>).

V

Në përputhje me Rregulloren për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve, si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të Thirrjes publike.

1. Komisioni Vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
2. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me Rregulloren për Financimin Publik të OJQ-ve.

VI

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit bie vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftojë përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij Vendimi është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

VII

Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit!



Kryetari i Komunës
Bexhet Xheladini